



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLICA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / ТЕЛО ЗА РАЗМАТРАНЈЕ НАБАВКИ

34-50121

NT/BF. 18.02.21

Datë/Datum.

PRISHTINË - PRISTINA

PSH.nr.34/21

50/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik “Pe-vla-ku” SH.P.K-Dega në Kosovë Prishtinë dhe OE SH “Drini Company” SH.P.K-Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik “Euroasphalt” SH.P.K. & “Trasing Group” SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-shpallje Ndërtimi i Qarkores -Tranziti i ri”, me nr. të prokurimit: 632-19-2998-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-Gjakovë”, më datën: 15.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “Pe-vla-ku” SH.P.K-Dega në Kosovë Prishtinë dhe OE SH “Drini Company” SH.P.K-Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ri-shpallje Ndërtimi i Qarkores -Tranziti i ri”, me nr. të prokurimit: 632-19-2998-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-Gjakovë”.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ri-shpallje Ndërtimi i Qarkores -Tranziti i ri”, me nr. të prokurimit 632-19-2998-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-Gjakovë”, dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “Pe-vla-ku” SH.P.K-Dega në Kosovë Prishtinë dhe OE SH “Drini Company” SH.P.K-Prizren, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatorët ekonomik ankues “Pe-vla-ku” SH.P.K-Dega në Kosovë Prishtinë dhe OE SH “Drini Company” SH.P.K-Prizren, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 11.01.2021 me nr.34/21, dhe me datë 16.01/2021 me nr.50/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ri-shpallje Ndërtimi i Qarkores -Tranziti i ri”, me nr. të prokurimit 632-19-2998-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-Gjakovë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 27, 28, 51, 56, 57, 59, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71 dhe nenin 72 të LPP-së, te ankesa me nr. 34/21.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 64, 66 dhe nenin 69 të LPP-së, te ankesa me nr. 50/21.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë 15.01.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datë 29.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Pe-vla-ku” SH.P.K-Dega në Kosovë Prishtinë
Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e OE “PE-VLA-KU” SH.P.K se ankues se me datën 07.09.2020, Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës ne sistemin elektronik e- Prokurim ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues, Konzerciumit te shpallur fitues, Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës nuk i kane kërkuar Vërtetimin e ATK-se për tre (3) mujorin e fundit, Vërtetimin e Gjykatës dhe Vërtetimin nga Komuna qe operatoret ekonomik te konzerciumit nuk kanë obligime te tatimit ne prone - siç edhe kane qene te përcaktuar ne FTD te dorëzohen, dokumente këto qe kërkohen para vendimit te AK për operatorin

ekonomik fitues dhe nëse nuk dorëzohen brenda afatit kohor të duhur oferta e OE fitues refuzohet dhe vazhdohet me operatorin në radhë. Nga Neni 65 deri tek neni 72 LPP i RKS.

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga ankues OE "PE-VLA-KU" SH.P.K se Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës nuk i kane kërkuar Vërtetimin e ATK-se për tre (3) mujorin e fundit, Vërtetimin e Gjykatës dhe Vërtetimin nga Komuna që operatorët ekonomik të konzerciumit nuk kanë obligime të tatimit në prone. Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës i ka kërkuar dhe grupi i operatoreve ekonomik i shpallur fitues Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K., i ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas kërkesës. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pabazuar

Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin nr.2 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K se ankues, se konzerciumi i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur vazhdimet e sigurimeve por vetëm kopje të sigurimeve të tyre. Sigurimi për operatorin ekonomik fitues është kërkuar origjinal, gjë që Autoriteti Kontraktues nuk posedon sigurimin origjinal të konzerciumit për këtë shkak që ne dyshojmë që këto polica të sigurimit janë anuluar menjëherë pasi që janë dërguar si skenime tek Autoriteti Kontraktues.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se grupi i operatoreve ekonomik : Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K., e ka dorëzuar sigurimin e tenderit në origjinal të datës 09/11/2020 me Numër të Polices 1017577 të leshur nga kompania e sigurimeve sh.a "KOSOVA e re", Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin nr.3 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K se ankues se Konzerciumi Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K., cili është rekomanduar për dhënien e kontratës ka paraqitur një Marrëveshje Konzerciumi, por jo të plot. Në të mungojnë deklarata si dhe në faqen e 3 thuhet se kontrata do të realizohet nga pesë (5) Operator Ekonomik.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3

Lidhur me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim në Dosjen e tenderit Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD) ; Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik; Neni 11.1

a.një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës

b.një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;

c.një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d.Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT. Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i operatorëve ekonomik i shpallur fitues Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K., në **MARRVESHJEN PER KRIJIMIN E NJE GRUPI TE OPERATOREVE EKONOMIK** i kane te plotësuar te gjitha pikat e kërkuara sipas Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE te Tenderit (FTD) ; Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik; Neni 11.1 pikat a. , b., c. Dhe d., Ndërsa sa i përket pretendimit te OE ankues se ne faqen e 3 thuhet se kontrata do te realizohet nga pese (5) Operator Ekonomik. Eksperti shqyrtues mendon se është një gabim minor i cili ka mundur te lëshohet gjate shkrimit te kësaj marrëveshje. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin nr.4 te OE “PE-VLA-KU” SH.P.K se ankues se konzerciumi ka paraqitur një marrëveshje e cila nuk është marrëveshje për gurthyes por është marrëveshje për rërë, zhavorr dhe sortues, ndërsa ne dosje te tenderit Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesionale është kërkuar Licence - leje e vlefshëm te lëshuar nga KPMM-ja ose kontrate nga një ndërmarrje e licencuar nga KPMM-ja Baze e betonit, baze për gurthyes dhe asfalt.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4

Lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues se grupi i OE “Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K” te shpallur fitues se ka paraqitur një marrëveshje e cila nuk është marrëveshje për gurthyes por është marrëveshje për rërë, zhavorr dhe sortues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin qe kam pranuar në shqyrtim Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i operatoreve ekonomik “Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K” ne dosjen e tenderit te dorëzuar ka bashkangjitur dhe këto licenca dhe kontrata:

LEJE PËR AKTIVITETET E VEÇANTA
DOZVOLE ZA POSEBNE AKTIVNOSTI / SPECIAL OPERATIONS PERMIT
601/KPMM/2018

Emri i Biznesit / Naziv Biznisa / Name of Business:	"Euroasphalt"sh.p.k.
Nr. i Biznesit / Br.Biznisa / Business No:	70511975
Nr. i Regjistrat / Br.Registracije / Registration No:	703
Prutar i Biznesit / Vlasnik Biznisa / Business Owner:	Alban Fetoshi; Kaltrin Kryeziu; Fatos Deva
Kohëzgjatja / Trajanje / Duration:	26/07/2023
Sipërfaqja / Površina / Surface area:	14103.65 m ²
Emri i vendit / Ime mesta / Site name:	Marmosll
Leje për / Dozvola za / Permit for:	Leje për / Dozvola za / Permit for:
Komuna / Opština / Municipality:	Gjebocë
baza e asfaltit / osnova za asfalt / asphalt base	
Të drejtat dhe detyrimet / Prava i obaveze / Rights and obligations:	

LEJE PËR AKTIVITETET E VEÇANTA
DOZVOLE ZA POSEBNE AKTIVNOSTI / SPECIAL OPERATIONS PERMIT
602/KPMM/2018

Emri i Biznesit / Naziv Biznisa / Name of Business:	"Etronsphali" sh.p.k.
Nr. i Biznesit / Br. Biznisa / Business No:	79541955
Nr. i Regjistrimit / Br. Registracije / Registration No:	904
Pronar i Biznesit / Vlasnik Biznisa / Business Owner:	/ Ilirija Fetushi; Kaltrina Kryeziu; Fatlos Deva
Kohëzgjatja / Trajanje / Duration:	26/07/2023
Emri i vendit / Ime mesta / Site name:	Murqull
Komuna / Opština / Municipality:	Gjakovë
Të drejtat dhe detyrimet / Prava i obaveze / Rights and obligations:	
Sipërfaqja / Površina / Surface area: 14103,65 m ²	
Leje për / Dozvola za / Permit for: baza e betonit / osnova za beton / concrete base	

LEJE PËR AKTIVITETET E VEÇANTA
DOZVOLE ZA POSEBNE AKTIVNOSTI / SPECIAL OPERATIONS PERMIT
522/KPMM/2017

Emri i Biznesit / Naziv Biznisa / Name of Business:	"Trasing Group" Sh.p.k.
Nr. i Biznesit / Br. Biznisa / Business No:	70323510
Nr. i Regjistrimit / Br. Registracije / Registration No:	774
Pronar i Biznesit / Vlasnik Biznisa / Business Owner:	Demir Berisha
Përfaqësuar nga/Predstavljen od/Represented by	Demir Berisha
Kohëzgjatja / Trajanje / Duration:	19/01/2022
Emri i vendit / Ime mesta / Site name:	Korvotice e eperme
Komuna / Opština / Municipality:	Glogoc
Të drejtat dhe detyrimet / Prava i obaveze / Rights and obligations:	
Sipërfaqja / Površina / Surface area: 18207,65 m ²	
Leje për / Dozvola za / Permit for: sortues / sortirac / crusher	

LICENCË SHFRYTËZIMI
RUDARSKA LICENCA / MINING LICENSE
1616/KPMM/2016

Emri i Biznesit / Naziv Biznisa / Name of Business:	"Vranina" Sh.p.k.
Nr. i Biznesit / Br. Biznisa / Business No:	71188965
Nr. i Regjistrimit / Br. Registracije / Registration No:	2152
Pronar i Biznesit / Vlasnik Biznisa / Business Owner:	Ukë Nimani,
Kohëzgjatja / Trajanje / Duration:	01/02/2029
Emri i vendit / Ime mesta / Site name:	Gllaviqice
Komuna / Opština / Municipality:	Pejë
Të drejtat dhe detyrimet / Prava i obaveze / Rights and obligations:	
Sipërfaqja / Površina / Surface area: 14239,13 m ²	
Grupa minerale / Mineralna grupa / Commodity group: Rëra dhe zhavorr / pesak i shjunak / sand and gravel	

MARREVESHJE BASHKËPUNIMI - FURNIZIMI

E Lidhur me : 01.05.2018 në mes:

Euroasphalt sh.p.k me seli në Gjakovë adresa:Skenderbeu Jasht Qytet , me numer biznesi 70511975,përfaqësuar nga Drejtoriz.Fatos Deva ne cilsin e blersit, dhe

" Vranina " sh.p.k me nr.biznesi 71188965 me seli në Gllavaçicë -Pejë te cilën e perfaqeson zot. Ukë Nimani Proeur , në cilsin e shitësit.

Neni 1.

Objekt i kesaj marreveshje e cila nenkupton bashkepunimin tekniko-afarist te puneve dhe aktiviteteve te tjera te karakterit punues,pjegjesishite furnizimin me Rere dhe Zhavor (të te gjitha Fraksioneve) nga Furnitori Vranina sh.p.k / Pejë per BASHKËPUNIM TË PËRHERSHËM per nevoja te blersit Euroasphalt sh.p.k-Gjakove.

Neni 2.

Palet janë pajtuar qe kjo marreveshje mbi furnizimin me zhavor do te jete e vlefshme per periadhen e lartcekur .

Neni 3.

Marreveshja eshte lidhur pa kushtezimë por vetem ne dobi afariste te te dy kompanive (paleve) te cilat njeherit dhe janë nenshkruese te kesaj marreveshje.

Neni 4.

Te dy palet jane pajtuar se obligimet e blersit perkatesisht Euroasphalt sh.p.k do te jete qeshtja e transportit te zhavorit nga shiti Vranina sh.p.k gjere ne destinacionin e nevojshem,gjersa obligimi i shitesit do te jete pergjegjesia mbi materialin e shitor,si dhe evidentimi (pasisja me evidence) perkatesisht Faturim i rregullt.

Neni 5.

Marreveshja eshte e perpiluar me kater kopje,dhe secila pale ka nga dy kopje.

Neni 6.

Ne raste eventuale te kontestit kompetent do te jete Gjykata Komunale Kompetente

"Euroasphalt" sh.p.k

"Vranina" sh.p.k
SH.P.K
VRANINA
691295351
Gllavaçicë
Activ

Te gjitha licencat dhe kontratat e dorëzuar nga grupi i operatoreve ekonomik janë te noterizuar nga noteri dhe janë me kohëzgjatje sipas kërkesës. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 5

Lidhur me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE "PE-VLA-KU" SH.P.K ankues se grupi i OE "Euroasphalt SH.P.K; &Trasing Group SH.P.K" te shpallur fitues se ka paraqitur si menaxher te projekti inxhinierin Fatmir Kryeziu-n, por në referencën për punë të kryera të kërkuara sipas dosjes se tenderit ka paraqitur për pune te kryera qe prej 2014 këtu vërejmë se ky inxhinier ka filluar pune ne kompaninë "Euroasphalt" SH.P.K qe nga viti 2014 ndërsa kontrata e punës se tij me këtë kompani është ne kundërshtim se kemi kontratë pune te viti 2017 saktësisht 30.12.2017.

Përgjigje në Pretendimin nr. 5

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE "PE-VLA-KU" SH.P.K ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin kontratën e punës te datës 31.12.2017 ne te cilën thuhet se:

KONTRATË PUNE

1. Me punëtorin Fatmir Kryeziu, i lindur ne Fsh.Xërxe-Rahovec, me Nr. Personal 1002737481. (në tekstin e mëtejme: **Punëtori**),

2. Punëtori /ja themelon marrëdhënie të rregullt të punës sipas kësaj kontrate pune e cila lidhet për kohë të caktuar dhe fillon me datën 01.01.2018 ndërsa përfundon me datën 31.12.2020.

3. Punëtori /ja sistemohet në vendin e punës si **Ing.i Ndërtimtaris**. Punëtori/ja është i obliguar që ti kryej detyrat e punës në të cilat është i përcaktuar sipas sistematizimit dhe përshkrimit të detyrave të punës, si dhe të gjitha punët tjera që i parashtrihen nga punëdhënësi.

Ne baze te kësaj Kontrate e cila është e noterizuar nga Notere Flutura Zajmi – Gjakove me datën 15.01.2019 z. Fatmir Kryeziu, themelon marrëdhënie pune te rregullte për kohe te caktuar me datën 30.12.2017 e cila fillon me datën 01.01.2018 ndërsa përfundon me datën 31.12.2020 ndërsa njoftimi për kontrate për këtë aktivitet te prokurimit “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores - Tranziti i ri” me nr. të prokurimit: 632-19-2998-5-1-1, është shpallur me datën 10.05.2019 përafërsisht 16 muaj me parë. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi nr. 6

Lidhur me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues se grupi i OE “Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K” te shpallur fitues se konzerciumi si Inxhinier te komunikacionit ka paraqitur Inxhinierin Albert Haxhikadria ka paraqitur referenca për pune te kryera nga kompania "Euroasphalt " Sh.P.K por qe ky inxhinier nuk figuron ne listën e punëtorëve te ATK-se.

Përgjigje në Pretendimin nr. 6

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE “PE-VLA-KU” SH.P.K ankues se grupi i OE “Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K” te shpallur fitues se konzerciumi si Inxhinier te komunikacionit ka paraqitur Inxhinierin Albert Haxhikadria ka paraqitur referenca për pune te kryera nga kompania "Euroasphalt " Sh.P.K por qe ky inxhinier nuk figuron ne listën e punëtorëve te ATK-se Eksperti shqyrtues sqaron ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate nuk është kërkuar qe stafi profesionalë të jetë në listën e ATK-së sepse Operatori ekonomik “Euroasphalt SH.P.K me Inxhinierin Albert Haxhikadria ka të nënshkruar kontratë mbi vepër sipas pikës II. për këtë projekt “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores - Tranziti i ri” me nr. të prokurimit: 632-19-2998-5-1-1, Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi nr. 7

Lidhur me pretendimin nr.7 te OE “PE-VLA-KU” SH.P.K se ankues se Kompania jone ka ofertuar me çmimin 3.474.948.86€ ju bëjmë me dije se ne si kompani qëndrojmë pran këtij çmimi te dhënë dhe nuk e

pranojmë ndryshimin dhe vazhdojmë të ofertojmë me këtë çmim. Nuk ka qenë vetëm kompania jone që ka bërë këtë devijim për arsyeje se gabimi ka qenë nga Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës, e cila e ka ngarkuar një paramasë kaq të madhe me gabime teknike.

Përgjigje në Pretendimin nr. 7

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim dhe Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pretendimin e parashtruar Eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: Për gabimet aritmetikore, flet paragrafi 3 i nenit 59 të LPP-së, si dhe neni 41.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik. Paragrafi 3 i nenit 59 të LPP-së, përcakton: "3. - Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy për qind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do të dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla". Paragrafi 3 i nenit 59 të LPP-së flet për gabimet tërësisht aritmetikore dhe si pas këtij paragrafi nëse gjatë vlerësimit të tenderëve AK zbulon mospërputhje në mes të çmimit për njësi dhe totalit, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe një përmirësim i tillë lejohet vetëm deri në 2% të vlerës totale të ofertës. Neni 41.8 i RRUOPP, përcakton: "41.8 AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy për qind (2%) i vlerës totale të ofertës. i. Në rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësojë gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B49. Në rast se OE në fjalë nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta në fjalë do të refuzohet. AK gjithashtu duhet të dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE të cilët kanë dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla. ii. Në rast se shuma e korrigjuar është me shumë se +/- 2%, AK do të eliminojë OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B42". Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues respektivisht komisioni për vlerësim të tenderëve e ka korrigjuar paramasën e OE e cila me rastin e dorëzimit ka pas vlerën në shumen = 3.474.948.86 € ndërsa pas korrigjimit të gabimit vlera e kontratës është = 3,496.317.76 € që i bie se ndryshimi është në shumen = 21.818,90 €. E cila shumë është me pak se 2%, vlerës së kontratës, dhe OE është i obliguar ta respektojë këtë ndryshim. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues SH "DRINI COMPANY" SH.P.K., i shpallur tenderues i eliminuar.

Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e OE SH "DRINI COMPANY" SH.P.K. ankues i shpallur si tenderues i eliminuar nga AK-ja, se nuk pajtohem me vendimin e AK pasi që na ka eliminuar pa baze sepse i plotësojmë të gjitha pikat e kërkuara në dosje të tenderit. AK e ka korrigjuar paramasen nga 2,999,470.00 € në 3,016,565.50 € që i bie diferencë prej 17,095.50 €. E cila është me pak se 2%, korrigjimi. Kjo nuk përben shkelje pasi që jemi në kuotën e lejuar me ligj, që është deri në 2% është i lejuar korrigjimi.

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim dhe Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pretendimin e parashtruar Eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: Për gabimet aritmetikore, flet paragrafi 3 i nenit 59 të LPP-së, si dhe neni 41.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik. Paragrafi 3 i nenit 59 të LPP-së, përcakton: "3. - Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy për qind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do të dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla". Paragrafi 3 i nenit 59 të LPP-së flet për gabimet tërësisht aritmetikore dhe si pas këtij paragrafi nëse gjatë vlerësimit të tenderëve AK zbulon mospërputhje në mes të çmimit për njësi dhe totalit, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe një përmirësim i tillë lejohet vetëm deri në 2% të vlerës totale të ofertës. Neni 41.8 i RRUOPP, përcakton: "41.8 AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy për qind (2%) i vlerës totale të ofertës. i. Në rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësojë gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B49. Në rast se OE në fjale nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta në fjale do të refuzohet. AK gjithashtu duhet të dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE të cilët kanë dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla. ii. Në rast se shuma e korrigjuar është me shumë se +/- 2%, AK do të eliminojë OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B42". Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues respektivisht komisioni për vlerësim të tenderëve e ka korrigjuar paramasen e OE e

cila me rastin e dorëzimit ka pas vlerën në shumen = 2,999,470.00 € ndërsa pas korrigjimit të gabimit vlera e kontratës është = 3,016,565.50 € që i bie se ndryshimi është në shumen = 17,095.50 €. E cila shumë është me pak se 2%, vlerës së kontratës. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin e OE SH "DRINI COMPANY" SH.P.K. ankues i shpallur si tenderues i eliminuar nga AK-ja se Inxhinier i i diplomuar i komunikacionit Bachelor me 5 vite përvojë pune.

Në dosje e kemi prezantuar inxhinierin z. Besar Krasniqi i cili ka diplomuar në vitin 2010 dhe sipas CV që ne e kemi prezantuar i ka 5 vite përvojë pune. Sa i përket gradës Bachelor tani me ekzistojnë vendimet e Panelit Shqyrtues të OSHP-së që këto janë quajtur devijime të vogla pasi që inxhinieri e plotësinë kërkesën e përvojës së punës. Edhe vete komuna e Gjakovës ka disa vendime ku OSHP i ka quajtur devijime të vogla gradën bachelor, në rastet ku inxhinieri e ka plotësuar përvojën e punës sipas kërkesës së AK.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimi i PSH.nr. 400/ 19 dhe 419/19 datë:06.09.2019; Vendimi i PSH .nr. 621/19 datë: 07.11.2019; Vendimin e PSH .nr. 829/19 datë: 27.12.2019 Vendimin e PSH .nr. 85/20 datë: 11.03.2020 dhe Vendimin e PSH .nr. 662/20 dhe 699/20 datë: 29.10.2020 në të cilin thuhet :

Pretendimi tjetër i OE ankues "PE-VLA-KU" SH.P.K se duke u bazuar në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2, si dhe duke u bazuar në nenin 69 Afësia Teknike dhe Profesionale të Ligji i Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, Ligjin 05/L092, vërejmë se Inxhinieri i prezantuar i komunikacionit nuk i përmbush kërkesat sipas dosjes së tenderit. Me dosjen e tenderit kërkohet: Një Inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike - drejtimi komunikacion (transport) me minimumi pesë [5] vite përvojë pune pas diplomimit. Ndërsa Operatori Ekonomik Sh Drini Company SH.P.K, ka ofruar diplomë Bachelor të komunikacionit rrugor dhe transportit gjë që nuk është inxhinier që i plotëson kriteret për këtë tender.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, nenin 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Pra, ky

Page 17 nga 24

pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimi i PSH.nr.400/19 dhe 419/19 datë 06.09.2019; Vendimi i PSH.nr.621/19 datë 07.11.2019; Vendimin e PSH.nr.829/19 datë 27.12.2019 dhe Vendimin e PSH.nr.85/20 datë 11.03.2020, ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit teknik të prokurimit vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Andaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin e OE SH “DRINI COMPANY” SH.P.K. ankues i shpallur si tenderues i eliminuar nga AK-ja se Ne dosje te tenderit dhe te njoftimit për kontrate për projektin e lartshënuar askund nuk është kërkuar DEKLARATË për specifikacione teknike. Nuk e di ku është thirrur AK dhe e ka kërkuar një gjë te tillë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE SH “DRINI COMPANY” SH.P.K ankues se AK-ja e me B42 Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar ne piken 3. me pretendim se : Tek specifikacioni teknik OE-se i mungojnë Deklaratat për specifikime teknike te detyrueshme te cilat duhet te ishin ne dosje . Eksperti shqyrtues gjate shqyrtimit te dokumentacionit respektivisht te dosjes se tenderit tek: Aneks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME thuhet: Referohuni në specifikimin teknik paramasa. Bazuar ne këto AK-ja nuk ka kërkuar Deklaratë për specifikime teknike dhe ky pretendim i operatorit ekonomik është i bazuar.

Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin e OE SH “DRINI COMPANY” SH.P.K. ankues i shpallur si tenderues i eliminuar nga AK-ja se OE i rekomanduar per kontrate nuk e plotëson këtë kërkesë pasi qe nuk ka kontrata dhe referenca qe e arrijnë vlerën e kërkuar per liderin 60%.

Ne dosje te tenderit është kërkuar:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 5.000.000,00€ , në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin qe kam pranuar në shqyrtim dhe listën e kontratave te dorëzuara sipas kërkesës ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit ne te cilën shihet nga tabela nr.1 e dhënë me poshtë se OE i shpallur fitues gjate tri viteve te fundit (2016; 2017 dhe 2018-2019) ka realizuar kontrata të natyrës së ngjashme për punime ne shumen prej 1.705.273,04 euro nga shume e kërkuar në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme $= 5.000.000,00 \times 60\% = 3.000.000,00$ euro te kërkuara për liderin e grupit. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 5

Lidhur me pretendimin e OE SH "DRINI COMPANY" SH.P.K. ankues i shpallur si tenderues i eliminuar nga AK-ja se grupi i OE: Euroasphalt SH.P.K & Trasing Group SH.P.K., i shpallur fitues ne dosje te tenderit ka prezantuar një Autorizim te kompanisë MGB per produktet SMARTI, Ndërsa ne ofertën e tij ka prezantuar katalogë te prodhuesit LUG nga Polonia per te cilin nuk është i autorizuar. Edhe pse i ka prezantuar këto produkte përsëri OE nuk i plotëson kërkesat minimale te AK

Përgjigje në Pretendimin nr. 5

Ekspteri shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin qe kam pranuar në shqyrtim dhe sqaron se Anëtari i grupit Euroasphalt SH.P.K me dosjen e tenderit ka dorëzuar autorizimin nga "MBG" SH.P.K.



Adresa: Jusuf Gërvalla 103, Prizren; Nr. tel: 044 168 954 |
www.mbg-ls.com | info@mbg-ls.com

Multi Business Group SH.P.K. / NRB: 70561926/ NRI: 600476908

PIRE KOMUNËN E GJAKOVËS

ITITULLI: NDËRTIMI I QARKORES – TRANZITI I RI

NR.I PROKURIMIT: 632-19-2998-5-1-1

NR.I BRENDSHËM: 632-19-002-511

AUTORIZIM

Me anë të këtij autorizimi unë Jeton Bytyqi – Drejtor i kompanisë "Multi Business Group SH.P.K." e autorizoj kompaninë Euroasphalt sh.p.k me nr. biznesi: 810793168 se mundë të ofertoj me te gjitha prodhimet dhe shërbimet e elektrikes per pasqet elektrike dhe trupat ndriqes te kompanis sone ne tendern e lartceluar dhe se te gjitha prodhimet dhe shërbimet tona jane te çertifikuara me standarte evropiane (EN).

Andaj unë Jeton Bytyqi – Drejtor i kompanisë "Multi Business Group SH.P.K." e jape kete autorizim me përgjegjesi te plote morale dhe mater ale.

Ky autorizim kompanis "Euroasphalt sh.p.k" i shërben vetem per projektin e lartëshënuar.

DATA: 24.05.2019

"Multi Business Group SH.P.K."

Z. Jeton Bytyqi – DREJTOR

për produktet SMART – TAB Systems Inc. është një zhvillues dhe prodhues i zgjidhjeve të përparuara teknologjike në fushën e sistemeve inteligjente të parkimit, zgjidhje automatike të automatizimit, zgjidhje inteligjente të ndriçimit LED nën emrin e markës smarti® “.



TAB Systems Inc.

Ljubljanska 24a, 4000 Kranj, Slovenia/EU

+386 4 500 10 00

info@tab-systems.com

www.tab-systems.com
www.smartlighting.com

In Kranj, 25th September 2018

TO WHOM IT MAY CONCERN:

We, "TAB Systems Inc. – smarti lighting, Ljubljanska 24a, 4000 Kranj, Slovenia" would like to confirm that our representative in Kosovo

Multi Business Group

Jusuf Gërvalla 103, Prizren

KOSOVO

is our exclusive sale partner and representative in Kosovo and also certified and trained by SMARTI lighting (TAB Systems Inc.) to handle all installments and repairs of SMARTI equipment.

Sincerely,

Tomaz Bergant

CEO

 **TAB Systems**
D.O.O. s.p.a. s.d.r.l.
Ljubljanska 24a
4000 Kranj

Ndërsa ne ofertën e tij ka prezantuar katalogë te prodhuesit LUG nga Polonia për te cilin nuk është i autorizuar.



Professional streetlight luminaire for LED light sources.

TECHNICAL DATA

Mounting: on pillar ø60/76mm, on pillar ø60/48mm (only for luminaires with a degree of regulation 0° ... +15°) - modification 834, on outriggers ø60/76mm, on outriggers ø60/48mm (only for luminaires with a degree of regulation 0° ... +15°) - modification 834

Body: high pressure die-cast aluminum

Lateral Surface Wind Exposed: 0.049 m²

Colour: gray, graphite

Diffuser: tempered glass

ELECTRICAL DATA

Power supply efficiency: >93%

Power: 220-240V 50/60Hz

Includes light source: yes

Type of equipment: f0

Electrical connection: max 3x2,5 mm² wire, max 2x2,5 mm² wire

OPTICAL DATA

Light distribution: asymmetric

Way of lighting: direct

Type of optic: 01 - for freeways, 02 - for express roads, 03 - for local roads, 04 - for town roads, 05 - for residential area roads, 07 - for area lighting, 08 - for town and local roads

U0/L0 / B10/L10: 0% / 100%

GENERAL DATA

Lifetime (L90B10): 100 000 h

Available on request: DALI, DIM L, DIM, LLOC, twilight sensor, 10kV surge protection, NTC

Additional information: tilt adjustment: 5°, knife switch (for protection class II), access to the driver chamber without the use of tools. The possibility of using one or more power supplies in the luminaire.

Additional equipment: luminaire with holder for mounting on a ø60/48mm pillar (only for luminaires with a degree of regulation 0° ... +15°) - index extension: 834

Other remarks: the pole and boom are not part of the luminaire

Warranty: 5 years

Application: freeways, express roads, local roads, town roads, residential area roads, area lighting



Si dhe katalogun smarti®. për te cilën është i autorizuar dhe është një zhvillues dhe prodhues i zgjidhjeve të përparuara teknologjike në fushën e sistemeve inteligjente të parkimit, zgjidhje automatike të automatizimit, zgjidhje inteligjente të ndriçimit LED nën emrin e markës smarti®.



H4
LED
Family of
Street Lights
Product Brochure



Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pabazuar

Pretendimi nr. 6

Lidhur me pretendimin e OE SH “DRINI COMPANY” SH.P.K. ankues i shpallur si tenderues i eliminuar nga AK-ja se OE i shpallur fitues : Euroasphalt SH.P.K & Trasing Group SH.P.K Për piken e autorizimit për sinjalizim horizontal dhe vertikal ka prezantuar një Autorizim për kompanisë ITK SH.P.K. nuk ka dëshmi se OE ITK SH.P.K. është distributor i autorizuar për Kosove i kompanisë 3M, ne dëshminë e sjellë thuhet se OE ITK SH.P.K është vetëm furnizuar me produkte te 3M, e jo ka drejte te distribuojë apo qe është përfaqësues i autorizuar i 3M. Gjithashtu nuk ka sjell asnjë dëshmi se kompania ITK SHPK, është distributor i autorizuar i kompanisë SĚARCO AG. Nuk ka asnjë dëshmi.

Përgjigje në Pretendimin nr. 6

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin qe kam pranuar në shqyrtim dhe autorizimet e dorëzuar nga OE i shpallur fitues : Euroasphalt SH.P.K & Trasing Group SH.P.K sqaron se OE Euroasphalt SH.P.K –Gjakove ka dorëzuar autorizimin ne mes te “International Traffic Kosova” I.T.K SH.P.K dhe “Euroasphalt SH.P.K”-Gjakove, ndërsa nuk ka dorëzuar autorizimin ne mes te “International Traffic Kosova” I.T.K SH.P.K dhe kompanisë SĚARCO –Austri për sinjalizim horizontal si dhe kompanisë Zvicerane 3M për sinjalizim vertikal. Me poshtë po japin autorizimin e dorëzuar te lidhur ne mes te “ Euroasphalt SH.P.K” dhe “International Traffic Kosova” I.T.K SH.P.K

AUTORIZIM

Me anë të këtij autorizimi, unë Drejtori i kompanisë "International Traffic Kosova" I.T.K sh.p.k" me seli në Pejë me përgjegjësi të plotë morale dhe materiale e autorizoj kompaninë Euroasphalt sh.p.k - Gjakovë me nr.biznesi:810793168 se gëzon të drejtën të ofertoj me të gjitha prodhimet dhe shërbimet tona për sinjalizim Horizontal(bazur në dëshminë mbështetëse të kompanisë SWARCO –AUSTRI) si dhe me sinjalizimin Vertikal (shih dëshminë mbështetëse nga kompania Zvicerane 3M) bazuar ispas seksionit II (fleta e të dhënave të tenderit nr nr. prokurimi: 632-19-2998-511) mbështetur me certifikatat e kualitetit sipas standardeve Evropiane valide për sinjalizim horizontal dhe vertikal.


International Traffic Kosova " I.T.K sh.p.k

Datë:24.05.2019.

Drejtor zot.Visar Muriqi

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 7

Lidhur me pretendimin e OE SH "DRINI COMPANY" SH.P.K. ankues i shpallur si tenderues i eliminuar nga AK-ja se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit pasi që ka sjellë katalogë dhe certifikata EN që nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. OE ka dorëzuar katalogë dhe certifikata të cilat nuk përkojnë me kërkesat e dosjes së tenderit edhe të cilat janë për kompani tjera që ky nuk është i autorizuar, siç është rasti me LUG, CEANSOL etj.

Përgjigje në Pretendimin nr. 7

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim dhe katalog-et dhe certifikatat EN e dorëzuar nga OE i shpallur fitues : Euroasphalt SH.P.K & Trasing Group SH.P.K sqaron se OE Euroasphalt SH.P.K –Gjakove ka dorëzuar katalogë dhe certifikata të cilat janë për kompani tjera që as njeri nga anëtarët e grupit "Euroasphalt SH.P.K & Trasing Group SH.P.K" e nuk janë të autorizuar, siç është rasti me LUG, CEANSOL, Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

nr.	Kontrata e realizuar nga kompania " Euroasfalt Shpk " te dorezuar sipas kriterit ne njoftimin per kontrate - lider i grupit duhet ti kete te realizuara 60% te 5.000.000,00 te shumes se kontratave /											
	Emri i kontrates	Shuma e kontratave te cilat nuk mirren ne vleresim					Shuma e kontratave te cilat mirren ne vleresim			Te dhena e kontrates		
		2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	nenshkrimi i kontratave	pranimi tek. /aprovimi	fillimi i shkrimit
1	Ndërtimi i Infrastrukturës në lagjen Kolonia-All faza e I dhe II.				87,851.35 €					13.06.2014	25.02.2016	2014
2	Ndërtimi -Asfaltimi i rrugës ne fsh.Ramos Lagja Selca			28,928.33 €						03.07.2013	25.02.2016	2013
3	Ndërtimi-Asfaltimi i rrugës Orize -Nije	70,870.39								25.11.2011	25.02.2016	2011
4	Ndërtimi i rrethrotullimit në rrugën "UGK" -Kol Leshi					112,790.71 €				19.04.2015	25.02.2016	2015
5	Ndërtimi-Asfaltimi i rrugës Rogovë-Ujç			234,763.85 €						17.09.2013	25.02.2016	2013
6	Ndërtimi Rrethit në Qendër të Gjakovës			289,655.72 €						02.10.2013	04.07.2016	2013
7	Ndërtimi-asfaltimi i rrugës Muharrem Dornit						117,836.68 €			19.12.2016	08.10.2017	2016
8	Ndërtimi-Asfaltimi i rrugës ne lagjen Pëpaq ne fshatin Brekoc				264,788.06					02.07.2017	25.02.2017	06.2017 / 11.2014
9	Ndërtimi-asfaltimi i rrugës ne Fshatin Popoc - Rruga e 5 Deshmorëve -Lagja Ahmetaj		64,258.31 €							18.10.2015	08.10.2017	2015
10	Ndërtimi-asfaltimi i rrugës Luga i Vades-Dol						134,714.79 €			17.08.2013	19.10.2017	11.10.2016
11	Ndërtimi-asfaltimi i rrugës Gjon Sereqi						70,461.16 €			29.04.2016	19.10.2017	2016
12	Ndërtimi -Ekzekutimi i Pilotos se Qendres Transport -Prizren									u/kanalizim		
13	Shtigjet për biçiklista në rrugën "UGK" dhe "Tirana"								78,923.13 €	18.06.2016	28.09.2018	11.10.2016
14	Ndërtimi i Infrastrukturës rrugore në lagjen "Kolonia-All" faza e III-të						3,288.96			19.04.2015	25.02.2016	2015
15	Ndërtimi-Asfaltimi rrugës Pjetershan - Kusar								99,916.92 €	11.12.2013	27.06.2018	06.11.2017
16	Ndërtimi-Asfaltimi rrugës Aleksander Bllodica Gjakovë						64,215.25 €			03.09.2016	20.09.2018	25.09.2016
17	Ndërtimi-Asfaltimi i rrugës në fsh.Novosell								87,745.00 €	03.09.2013	27.06.2018	06.04.2018
18	Ndërtimi-Asfaltimi i rrugës në fsh.Gërginë Lagja Sejdoj			338,433.55 €						02.09.2013	27.06.2018	2013
19	Ndërtimi-asfaltimi i rrugës Petro Nini Laurasi dhe kanalizimi atmosferik të saj							144,996.34 €		13.01.2017	27.06.2018	2017
20	Ndërtimi i rrugës në fshatin Rashko L=1+349.35 m'							94,328.72 €		07.10.2017	25.10.2018	2017
21	Ndërtimi i rrugës në fshatin Lughunar L=1+974.53 km'							94,263.32 €		13.09.2018	25.10.2018	2018
22	Ndërtimi-asfaltimi i rrugës se vitesave ne fsh.Dujakë,Krahu 1: L= 0+230.86 km dhe Krahu2: L=0+141.64 km								44,414.76 €	08.05.2018	25.10.2018	2018
23	Ndërtimi dhe Asfaltimi rrugës Skijari Novoseli K.Gjakovë								282,724.93 €	oktobar_2019	04.07.2018	
24	Asfaltimi rrugës Isa dhe Valdet Kuqi,Drejtimi kanali Bëlgjat-Deam						352,483.06 €			06.11.2016	12.10.2016	
shuma e realizuar		70,870.39	64,258.31	338,763.72	372,117.41	112,790.71	857,862.92	274,325.06	617,916.36			
						1,519,768.04			1,705,273.04			
									3,325,041.08			

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen pjesërisht si te bazuara, të ANULOHE T Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. dhe rekomandon që lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 01.02.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues me datë 04.02.2021, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik "Pe-vla-ku" SH.P.K-Dega në Kosovë Prishtinë, me datë 02.02.2021, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

PËR : ORGANIN SHYQRTUES TE PROKURIMIT PUBLIK "OSHP" , me adrës: Rr.Migjeni (ish Banka e Lubjanës kati i V-te), Prishtine, Republika e Kosovës

NGA: "PE-VLA-KU" SH.P.K-dega ne Kosove, me numër unik identifikues: 810794463, me adresës: Rr.Jakov, Xaoxa, L-A, K-7, Nr.54,10000, Prishtine, Republika e Kosovës, me përfaqësues me autorizim z. Arben SADRIJA PËRGJIGJJA NE MENDIMIN E EKSPERTITI SHYQRTUES

Duke u bazuar ne nenin 115 paragrafi 1 i Ligjit te Prokurimit Publike te Republike se Kosove 04/L-042 i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, ne Operatori Ekonomik "PE-VLA-KU" SH.P.K - dega ne Kosove me te dhënat si me larte dhe si parashtrues i ankesës numër: 34/21 te parashtruar me datën : 11.01.2021, nuk pajtohem me mendimin e ekspertit shqyrtues për lenden: "Ri - Shpallje Ndërtimi i Qarkores -Tranziti i Ri" me numër te prokurimit : 632-19-2998-5-1-1 dhe me Autoriteti Kontraktues : Komuna e Gjakovës .

Operatori ekonomik SH "Drini Company" SH.P.K-Prizren, me datë 05.02.2021, me anë të parashtrës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përshëndetje te nderuar,

Ne në parim pajtohem me mendimin e ekspertit për kthim ne RIVLERESIM te këtij aktiviteti te prokurimit.

Mirëpo nuk pajtohem me disa konstatime te ekspertit për disa pretendime tona.

Me arsyetimin si ne vijim:

Pretendimi 1

Pajtohem me konstatimin e ekspertit

Pretendimi 2

Nuk pajtohem me mendimin e ekspertit

Ne e kemi plotësuar këtë kërkesë te AK, pasi qe ne kemi dorëzuar Inxhinierin e kërkuar ne dosje te tenderit,

Pretendimi 3

Pajtohem me mendimin ekspertit,

Pretendimi 4

Pajtohem me mendimin e ekspertit

Pretendimi 5

Nuk pajtohem me mendimin e ekspertit

OE ofertues nuk ka ofertuar variante për turpa ndriçues, Ato produkte te kompanisë SMARTI, nuk e plotësojnë kërkesën e AK

Ndërsa për disa produkte ka vendosur katalogë te kompanisë LUG, për te cilën nuk ka autorizim.

Pretendimi 6

Pajtohem me mendimin e ekspertit

Pretendimi 7

Pajtohem me mendimin e ekspertit,

Me respekt,

Autoriteti kontraktues me datë 11.02.2021, pas seancës dëgjimore dërgon parashtrësë në OSHP si me poshtë:

From: Faton Gutaj <faton.gutaj@rks-gov.net>

Sent: 11/Feb/21 14:59

To: OSHP <oshp@rks-gov.net>; Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>; Goran Milenkovic <Goran.Milenkovic@rks-gov.net>; Nuhi Paqarizi <Nuhi.Paqarizi@rks-gov.net>

Cc: Xhelal Halilosmani <Xhelal.Halilosmani@rks-gov.net>

Subject: 34-50/21 seanca e dates 11.02.201 ne ora 12:00

Te nderuar,

Për seancën e mbajtur me dt.11.02.2021 në ora 12:00 për tenderin Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores - Tranziti i ri me nr.prokurimit 632-19-2998-5-1-1, konform kërkesës suaj që t'ua dërgojmë atë çfarë është thene gjatë seancës meqenëse nuk dëgjohej mire zëri nga AK, me poshtë po ua dërgojmë me tekst atë çfarë është thene: Autoriteti Kontraktues Komuna Gjakovë për Operatorin Ekonomik ankues nr. 1.“Pe-Vla- Ku” SH.P.K. – Dega në Kosovë - Prishtinë pajtohem me mendimin e ekspertit, kurse për Operatorin Ekonomik ankues nr. 2. SH “Drini Company” SH.P.K- Prizren nuk pajtohem me mendimin e ekspertit. Kjo, pasi që në bazë të vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit të dt. 29.10.2021 me PSH . nr. 662/20, 699/20, në faqe 22 lidhur me vendimin e Panelit Shqyrtues nr. 662,699/20 është thene që të kërkohej sqarime tek OE i rekomanduar për dhënie dhe sipas këtij vendimi AK ka kërkuar këto sqarime. Për me shume, ju lutem shihni me poshtë pjesën e vendimit:

Lidhur me pretendimin e OE ankues "EUROASPHALT" SH.P.K. në lidhje me arsyen e AK-së për eliminimin tonë ju sqarojmë se arsyetimi i AK-së është i pa bazuar pasi që ne e përmbushim kërkesën në lidhje me 60% kontratën të ngjashme, sepse AK-ja tek lista e projekteve të prezantuar nga ne, nuk e ka logaritur fare kontratën me titull Ndërtimi Ekzekutimi i pllatos së Qendres Tregtare-Prizren e cila kontratë ka shifrën prej 251,573.30 €, ndërsa në kuadër të kësaj kontrate hyn edhe aneksi kontratë me titull Punimi i pllatos (parkingut) me asfalt për Qendrën Tregtare-Prizren e cila e ka vlerën prej 80,000.00 €, e ku të dyja këto e kapin vlerën prej 331,573.30 €, vlerë kjo që dëshmon se lideri e plotëson kërkesën e FDT-së prej 60 % të vlerës së kontratave. Ju sqarojmë se gjatë dorëzimit të ofertës ka ndodhur një lëshim teknik nga ana jonë ku nuk është bashkangjitur referenca ose pranimit teknik i kësaj kontrate, mirëpo AK-ja nëse ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me kontratën e lartpërmendur atëherë ka mundur që në bazë të dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkojë sqarime shitesë nga ne dhe jo automatikisht të na eliminojë. Në lidhje me këtë kontratë ekzistojnë referenca dhe procesverbali i pranimit teknik i aneks kontratës, ndërsa po ashtu ekzistojnë edhe dëshmitë bankare me të gjitha pagesat që janë bërë për këtë kontratë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka qenë i obliguar të veprojë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së, si dhe nenin 39.8 të RRUOPP në bazë të cilit AK-ja duhet të bëjë sqarimin e tenderëve.

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Mungon referenca/certifikata e pranimit	Mund të kërkohej informata	69
nga lista e kontratave të prezantuara	sqaruese	

Faqe 22 nga 24

Me respekt

Faton Gutaj

Zyra e Prokurimit

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën 11.02.2021, te mbajtur nëpërmjet platformës elektronike ZOMM në ora 12:00 ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-së ankues, përfaqësuesit AK-së, eksperti shqyrtues, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtrësit e palëve në procedurë.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me përbërjen e panelit, dhe pasi konstatoi se nga të pranishmit nuk pati vërejtje në këtë përbërje, vazhdoi me seancën.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me objektin e shqyrtimit si dhe me shkresat e lëndës dhe në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së ankues se parëi cili deklaroj : ne baz te vlersimit te fundit qe ka bere AK Komuna e Gjakoves ne e kemi par qe nuk jan bere ne menyrt te duher te ligjit te prokurimit publik ne Republikën e Kosovës ne kemi kërkuar qasje ne dokumentet e grupit te OE euroasfal qe është baretes i konzorciumit te kompania tjetër trasing me qasjen ton ne dokumentet e këtij konzorciumi kemi vërejtur se OE te rekomanduar për dhënie te kontratës nuk kanë poseduar vërtetimin e administratës tatimore vërtetimin e tatimit ne pronë certifikatën gjykatës ekonomike . AK ne ate moment nuk i ka pasur dokumentat kur ne kemi qen prezent per marrjen e dok mentave pika e dyte te cilën ne jemi ankuar te ky konzorcium është se ne ne deklaratën me marrëveshjen e një konzorciumi ose marrëveshjen e një grupi operatorve ju mungojn dy deklarata , deklarata ne te cilën shihet qart se secila antar i gruoit te jen bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për mirëmbajtjen te nje grupi OE gjithashtu nje deklarate te nënshkruar nga secili anëtar duke e konfirmuar pjesëmarrjen e tij ne grup ose qe janë vetëm. Ne baze te kësaj ne dosjen e tenderit ka qen edhe njëra prej kriterëve keqen se kompanitë te cilat dëshirojnë te ofertojnë te kenë baze te asfaltit gurthyes dhe baze te betonit kompania ne fjalë, konzorciumi ne fjalë nuk ka arritur te dëshmoj se ka gurthyes aj ka paraqitur vetëm një marrëveshje ne te cilën është vetëm sortues dhe zhavor . pika tjetër për te cilën ne mendojmë qe është e pa ligjshme dhe nuk është ne rregull, menaxheri i projektit Fatmir Kryeziu ka paraqitur referenca qe nga viti 2014 mirëpo kontrata e këtij inxhinieri eshte nga viti 2017 shaka qe na jep te dyshojmë qe ato referenca nuk janë origjinal ose nuk ka qen i angazhuar aj inxhinier . pika tjetër është po ashtu te inxhinieri tjetër me emrin Albert Haxhikadriaj është paraqitur si punëtor i tyre mirëpo inxhinieri i ne fjal nuk eshte ne listën e administratës tatimore eshte paraqitur kontrata e punës por nuk eshte paraqitur lista nga administrata tatimore nuk eshte te gjitha këto konstatimet na bëjnë te dyshojmë se nuk jan ne rregull ne lidhje me konzorciumin ne fjal . ne si kompani jemi eliminuar nga AK jemi shpallur ne fakt si te pa suksesshëm për shkak te ndryshimit te qmimit por ne ketë gjë nuk e oranojm për arsye se çmimi jon është ne diferencën qe

kam bere eshte me i vogel se 2 % ne jemi me te lir ne jemi me te lir me qmimin e ofruar se kompania ose konzorciumi euroaspahalt jemi 13.678 euro dmth qe jemi shumo me te lir se ata dhe diferenca e çmimit mrena na e lejon ligji i republikës se kosoves qe te kemi kete ndryshim gjithashtu ne nuk pajtohemi me mndimin e ekspertit i cili ka ber egzaminim apo je vlerësim jo ne mënyrë te duhur ne qysh e mendojmë për arsyeje se nuk i ka cekur te gjitha këto pretendime tona nuk e di se qka paraqit AK ne lidhej me kete por po klerkoj nga eksperti qe nëse i ka këto deklarat qe supozojn ose qe nuk kemi paur qasje ne to te na e prazantoj edhe ti shohim se jan ato kontrata ato dëshmi , gjithashtu sigurimet te cilat ne i kemi kerkuar nga AK perarsyet e vazhdimin qe është bere 3 4 here nuk i ka poseduar origjinal qe duhet te posedohet sigurimi origjinal ne mendojmë qe ato sigurime nuk jan ma prezentë për arsye se kanë qen vetëm kopje , kanë mundur qe ato sigurime te anulohen pas kohës se dorëzimit me një imell ose ku ta di unë .ne qëndrojmë prapa qimit te dhen e pranoj me ate çmim dhe dëshirojmë qe ta marrim kontratën jemi OE te përgjegjshëm me te lirit

Ne vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së ankues se dyte i cili deklaroj : Ne ne parim pajtohemi me ekspertin per kthim ne rivlerësim te këtij aktiviteti te prokurimit se shum qart ne menyrr objektive se prej 7 pretendimeve qe i kemi pas ne ankes i ka vërtetuar 5 prej tyne dmth qe jan te lidhura ngushtë me përgjegjshmërinë e OE te rekomanduar per kontrat dmth e ka vërtetu qe OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterine liderit sa i përket referencave ashtu si qeshte kerku ne dosjen e tenderit nuk e plotëson kriterin e autorizimeve dhe katalogjeve per trupat ndrques edhe per trupat horizontal edhe vertikal dhe ne menyrr objektive e ka shpjegu edhe eksperti ne ekspertizën e vet , mirp nuk pajtohemi me nje pik te ekspertit sa i përket anulimit ton për këtë aktivitet te prokurimit qe është edhe e vetmja pik qe eshte përsërit dmth na nnga ky aktivitet jemi eliminu për shaka se kemi ofertua një inxhinier baqellor te komunikacionit qe ka qen njana prej 30kerkesave se kan qen ne dosjen e tenderit na ne këtë aktivitet te prokurimit jemi OE qe i jem rreth 20% ma lir se OE i rekomandum për kontratë dmth diferenca prej 500.000 eurovev dhe ky pretendim i eliminimit tone mendojmë qe është i pa baze sepse ka ehe raste tjera edhe vet ne komunën e Gjakovës ku janë quajt devijime te vogla një inxhinier baqellor cili e ka pas përvojën e pune sinë rastin tone.ne kemi me përcjell edhe vendime me raste te ngjashëm nuk kemi me shtu mashum se edhe eksperti ka vërtetu krejt shumë edhe ne mnyrr objektive edhe eksperti qe OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm, i vetmi gabim ne dosjen te=tenderit eshte inxhinieri qe e kemi ofertu na

Ne vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të AK-së i cili nuk i kishte te rregulluara pajisjet teknike dhe ka mbetur qe te dërgoj ne email fjalimin e tij sepse nuk dëgjohej.

Ne fjalën përfundimtare Eksperti deklaroj : OE i shpallur fitues nuk i plotëson mas pari kërkesën per kontratat qe mrena tre viteve te fundit me qen 5 milion vler aj ka vler 2 milion 705.000 dmth nuk ka vler brenda tre viteve a esht dashur mi pas 60% te 5 milionve, jo gurthyes ka se oshte me kta trasingu ka gurthyes trasingu

ka liqenc e ka gurthyesin i ka krejt , nuk i plotëson edhe autorizimin per trupa ndriques, i ka 7 pretendime prej 7 nja e ka t pa bazume mbetem pran raportit te dhen ne ekspertiz.

AK e ka dërguar emailin si me poshtë:

From: Faton Gutaj <fatongutaj@rks-gov.net>

Sent: 11/Feb/21 14:59

To: OSHP <oshp@rks-gov.net>; Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>; Goran Milenkovic <Goran.Milenkovic@rks-gov.net>; Nuhi Paqarizi <Nuhi.Paqarizi@rks-gov.net>

Cc: Xhelal Halilosmani <Xhelal.Halilosmani@rks-gov.net>

Subject: 34-50/21 seanca e dates 11.02.201 ne ora 12:00

Te nderuar,

Për seancën e mbajtur me dt.11.02.2021 në ora 12:00 për tenderin Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores - Tranziti i ri me nr.prokurimit 632-19-2998-5-1-1, konform kërkesës suaj që t'ua dërgojmë atë çfarë është thene gjate seancës meqenëse nuk dëgjohej mire zëri nga AK, me poshtë po ua dërgojmë me tekst atë çfarë është thene:

Autoriteti Kontraktues Komuna Gjakovë për Operatorin Ekonomik ankues nr. 1. "Pe-Vla- Ku" SH.P.K. – Dega në Kosovë - Prishtinë pajtohem me mendimin e ekspertit, kurse për Operatorin Ekonomik ankues nr. 2. SH "Drini Company" SH.P.K- Prizren nuk pajtohem me mendimin e ekspertit. Kjo, pasi që në bazë të vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit të dt. 29.10.2021 me PSH . nr. 662/20, 699/20, në faqe 22 lidhur me vendimin e Panelit Shqyrtues nr. 662,699/20 është thene që të kërkohej sqarime tek OE i rekomanduar për dhënie dhe sipas këtij vendimi AK ka kërkuar këto sqarime. Per me shume, ju lutem shihni me poshtë pjesën e vendimit:

Lidhur me pretendimin e OE ankues "EUROASPHALT" SH.P.K. në lidhje me arsyen e AK-së për eliminimin tonë ju sqarojmë se arsyetimi i AK-së është i pa bazuar pasi që ne e përmbushim kërkesën në lidhje me 60% kontrata të ngjashme, sepse AK-ja tek lista e projekteve të prezantuar nga ne, nuk e ka llogaritur fare kontratën me titull "Ndërtimi Ekzekutimi i pllatës së Qendres Tregtare-Prizren e cila kontratë ka shërbim prej 251,573.30 €, ndërsa në kuadër të kësaj kontrate hyjnë edhe aneksi kontratë me titull "Pamimi i pllatës (parkingut) me asfalt për Qendren Tregtare-Prizren e cila e ka vlerën prej 80,000.00 €, e ka të dyja këto e kapin vlerën prej 331,573.30 €, vlerë kjo që dëshmon se lideri e plotëson kërkesën e FDI-të prej 60.5% të vlerës së kontratave. Ju sqarojmë se gjatë dorëzimit të ofertës ka ndodhur një testim teknik nga ana jonë ku nuk është bashkangjitur referenca ose pranimit teknik i kësaj kontrate, mirëpo AK-ja ndëse ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me kontratën e lartpërmendur atëherë ka mundur që në bazë të dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkojë sqarime shtesë nga ne dhe jo automatikisht të na eliminonë. Në lidhje me këtë kontratë ekzistojnë referenca dhe procesverbali i pranimit teknik i aneks kontratës, ndërsa po ashtu ekzistojnë edhe dëshmitë bankare me të gjitha pagesat që janë bërë për këtë kontratë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka qenë i obliguar të vepronte në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së, si dhe nenin 39.8 të RRUCPP në bazë të cilit AK-ja duhet të beje sqarimin e tenderëve.

Problemi	Si të vepronet?	Neni i LPP-së
Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara	Mund të kërkohej informata sqaruese	69

Faqe 22 nga 24

Me respekt
Faton Gutaj
Zyra e Prokurimit
KK Gjakove

Paneli shqyrtues ne vazhdim jep pergjigjet per OE ankues "PE-VLA-KU" SH.P.K:

Lidhur me pretendimin e OE "PE-VLA-KU" SH.P.K, se me datën 07.09.2020, autoriteti kontraktues në sistemin elektronik e-Prokurim ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku konzorciumit të shpallur fitues nuk i kanë kërkuar vërtetimin e ATK-së për tre (3) mujorin e fundit, vërtetimin e Gjykatës dhe vërtetimin nga Komuna që operatorët ekonomik të konzorciumit nuk kanë obligime të tatimit në pronë, siç edhe kanë qenë të përcaktuara në FTD të dorëzohen, dokumente këto që kërkohen para vendimit të AK për operatorin ekonomik fitues dhe nëse nuk dorëzohen brenda afatit kohor të duhur, oferta e OE fitues refuzohet dhe vazhdohet me operatorin në radhë nga neni 65 deri tek neni 72 i LPP-së.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues "PE-VLA-KU" SH.P.K, se autoriteti kontraktues nuk i kanë kërkuar vërtetimin e ATK-së për tre (3) mujorin e fundit, vërtetimin e Gjykatës dhe vërtetimin nga Komuna që operatorët ekonomik të konzorciumit nuk kanë obligime të tatimit në pronë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues i ka kërkuar dhe grupi i operatorëve ekonomik i shpallur fitues Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K., i ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas kërkesës. Prandaj, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr.2 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K, se konzorciumi i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur vazhdimet e sigurimeve por vetëm kopje të sigurimeve të tyre. Sigurimi për operatorin ekonomik fitues është kërkuar origjinal, gjë që autoriteti kontraktues nuk posedon sigurimin origjinal të konzorciumit për këtë shkak që ne dyshojmë që këto polica të sigurimit janë anuluar menjëherë pasi që janë dërguar si skenime tek autoriteti kontraktues.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues, sqaron se grupi i operatorëve ekonomik Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K., e ka dorëzuar sigurimin e tenderit në origjinal të datës 09/11/2020 me numër të policës 1017577, të lëshuar nga kompania e sigurimeve "Kosova e Re" Sh.A. Prandaj, ky pretendim i OE ankues është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr.3 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K, se konzorciumi Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K., cili është rekomanduar për dhënien e kontratës ka paraqitur një marrëveshje konzerciumi, por jo të plotë. Në të mungojnë deklarata si dhe në faqen e 3 thuhet se kontrata do të realizohet nga pesë (5) operator ekonomik.

Lidhur me këtë pretendim ankimor të parashtruar nga OE ankues, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, duke u bazuar në dosjen e tenderit, Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD); Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik; Neni 11.1; a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës; b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar

pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se grupi i operatorëve ekonomik i shpallur fitues Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K., në marrvëshjen për krijimin e një grupi të operatorëve ekonomik i kanë plotësuar të gjitha pikat e kërkuara sipas Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE te Tenderit (FTD) ; Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik; Neni 11.1 pikat a. , b., c. dhe d. Ndërsa, sa i përket pretendimit të OE ankues se në faqen e 3 thuhet se kontrata do të realizohet nga pesë (5) Operator Ekonomik. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se është një gabim minor i cili ka mundur të lëshohet gjatë shkrimit të kësaj marrëveshje.

Lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE “PE-VLA-KU” SH.P.K, se grupi i OE “Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K” të shpallur fitues se ka paraqitur një marrëveshje e cila nuk është marrëveshje për gurthyes por është marrëveshje për rërë, zhavorr dhe sortues, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se grupi i operatorëve ekonomik “Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K” në dosjen e tenderit të dorëzuar ka bashkangjitur licenca dhe kontrata të cilat janë bashkangjitur në raportin e ekspertit shqyrtues. Të gjitha licencat dhe kontratat e dorëzuar nga grupi i operatorëve ekonomik, janë të noterizuara nga noteri dhe janë me kohëzgjatje sipas kërkesës. Andaj, ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE “PE-VLA-KU” SH.P.K , se grupi i OE “Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K” të shpallur fitues se ka paraqitur si menaxher të projektit inxhinierin Fatmir Kryeziu, por në referencën për punë të kryera të kërkuara sipas dosjes se tenderit ka paraqitur për punë të kryera që prej 2014, këtu vërejmë se ky inxhinier ka filluar punën në kompaninë "Euroasphalt" SH.P.K që nga viti 2014, ndërsa kontrata e punës së tij me këtë kompani është në kundërshtim se kemi kontratë pune të vitit 2017, saktësisht 30.12.2017.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në kontratën e punës të datës 31.12.2017, e lidhur me punëtorin Fatmir Kryeziu, ku kjo kontratë është e noterizuar nga Noteri Flutura Zajmi – Gjakovë me datën 15.01.2019, ku ceket se z. Fatmir Kryeziu, themelon marrëdhënie pune të rregullt për kohë të caktuar me datën 30.12.2017, e cila fillon me datën 01.01.2018 ndërsa përfundon me datën 31.12.2020, ndërsa njoftimi për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores - Tranziti i ri” me nr. të prokurimit: 632-19-2998-5-1-1, është shpallur me datën 10.05.2019 përafërsisht 16 muaj më parë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE "PE-VLA-KU" SH.P.K se grupi i OE "Euroasphalt SH.P.K; & Trasing Group SH.P.K" të shpallur fitues se ky konzorcium si Inxhinier të komunikacionit ka paraqitur Inxhinierin Albert Haxhikadria, ka paraqitur referenca për punë të kryera nga kompania "Euroasphalt " Sh.P.K por që ky inxhinier nuk figuron në listën e punëtorëve të ATK-së, sqaron se në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk është kërkuar që stafi profesional të jetë në listën e ATK-së sepse operatori ekonomik "Euroasphalt SH.P.K me Inxhinierin Albert Haxhikadria ka të nënshkruar kontratë mbi vepër sipas pikës II. për këtë projekt "Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores - Tranziti i ri" me nr. të prokurimit: 632-19-2998-5-1-1. Andaj, pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr.7 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K, se kompania jonë ka ofertuar me çmimin 3.474.948.86€, ju bëjmë me dije se ne si kompani qëndrojmë pranë këtij çmimi të dhënë dhe nuk e pranojmë ndryshimin dhe vazhdojmë të ofertojmë me këtë çmim. Nuk ka qenë vetëm kompania jonë që ka bërë këtë devijim për arsyeje se gabimi ka qenë nga autoriteti kontraktues, e cila e ka ngarkuar një para masë kaq të madhe me gabime teknike.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor, sqaron se për gabimet aritmetikore është përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 59 të LPP-së, si dhe në nenin 41.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik. Paragrafi 3 i nenit 59 të LPP-së, përcakton:

"3. - Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy për qind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla".

Paragrafi 3 i nenit 59 të LPP-së flet për gabimet tërësisht aritmetikore dhe sipas këtij paragrafi, nëse gjatë vlerësimit të tenderëve AK zbulon mospërputhje në mes të çmimit për njësi dhe totalit, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe një përmirësim i tillë lejohet vetëm deri në 2% të vlerës totale të ofertës. Kurse, në nenin 41.8 të RRUOPP-së, është përcaktuar:

"41.8 AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy për qind (2%) i vlerës totale të ofertës. i. Në rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësojë gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B49. Në rast se OE në fjalë nuk

pranon përmirësimin e gabimit, oferta në fjale do të refuzohet. AK gjithashtu duhet ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE të cilët kanë dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla. ii. Në rast se shuma e korrigjuar është me shume se +/- 2%, AK do të eliminojë OE dhe do të informojë me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B42".

Pra, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues, respektivisht komisioni për vlerësim të tenderëve e ka korrigjuar para masën e OE, e cila me rastin e dorëzimit ka pas vlerën në shumën 3.474.948.86€, ndërsa pas korrigjimit të gabimit, vlera e kontratës është 3,496.317.76€, që i bie se ndryshimi është në shumën 21.818,90€. E cila shumë është më pak se 2% e vlerës së kontratës dhe OE është i obliguar ta respektoj këtë ndryshim.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues SH "DRINI COMPANY" SH.P.K., i shpallur tenderues i eliminuar.

Lidhur me pretendimin e OE SH "DRINI COMPANY" SH.P.K. i shpallur si tenderues i eliminuar nga AK-ja, se nuk pajtohem me vendimin e AK pasi që na ka eliminuar pa bazë sepse i plotësojmë të gjitha pikat e kërkuara në dosje të tenderit. AK e ka korrigjuar para masën nga 2,999,470.00€ në 3,016,565.50€, që i bie diferencë prej 17,095.50€. E cila është më pak se 2% korrigjimi. Kjo nuk përben shkelje pasi që jemi në kuotën e lejuar me ligj, që është deri në 2% i lejuar korrigjimi.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues, sqaron se për gabimet aritmetikore është përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 59 të LPP-së, si dhe neni 41.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik. Paragrafi 3 i nenit 59 të LPP-së, ku është përcaktuar:

"3. - Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy për qind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla".

Paragrafi 3 i nenit 59 të LPP-së flet për gabimet tërësisht aritmetikore dhe si pas këtij paragrafi nëse gjatë vlerësimit të tenderëve AK zbulon mospërputhje në mes të çmimit për njësi dhe totalit, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe një përmirësim i tillë lejohet vetëm deri në 2% të vlerës totale të ofertës. Po ashtu, edhe neni 41.8 i RRUOPP ka përcaktuar:

“41.8 AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy për qind (2%) i vlerës totale të ofertës. i. Në rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësojë gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B49. Në rast se OE në fjalë nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta në fjalë do të refuzohet. AK gjithashtu duhet të dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE të cilët kanë dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla. ii. Në rast se shuma e korrigjuar është me shumë se +/- 2%, AK do të eliminojë OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B42”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues, respektivisht komisioni për vlerësim të tenderëve e ka korrigjuar para masën e OE e cila me rastin e dorëzimit ka pas vlerën në shumën 2,999,470.00€, ndërsa pas korrigjimit të gabimit vlera e kontratës është 3,016,565.50€, që i bie së ndryshimi është në shumën 17,095.50€. Shumë e cila është më pak se 2% e vlerës së kontratës. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues SH “DRINI COMPANY” SH.P.K. i shpallur si tenderues i eliminuar nga AK-ja, se Inxhinier i diplomuar i komunikacionit Bachelor me 5 vite përvojë pune, ku në dosje e kemi prezantuar inxhinierin z. Besar Krasniqi, i cili ka diplomuar në vitin 2010 dhe sipas CV që ne e kemi prezantuar i ka 5 vite përvojë pune. Sa i përket gradës Bachelor tani me ekzistojnë vendimet e Panelit Shqyrtues të OSHP-së, që këto janë quajtur devijime të vogla pasi që inxhinieri e plotësinë kërkesën e përvojës së punës. Edhe vetë komuna e Gjakovës ka disa vendime, ku OSHP i ka quajtur devijime të vogla për gradën bachelor, në rastet kur inxhinieri e ka plotësuar përvojën e punës sipas kërkesës së AK.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim është shqyrtuar më parë në Vendimin PSH.nr.400/19 dhe 419/19 të datës 06.09.2019, Vendimin PSH.nr.621/19 të datës 07.11.2019, Vendimin PSH.nr.829/19 të datës 27.12.2019, Vendimin PSH.nr.85/20 të datës 11.03.2020 dhe Vendimin PSH.nr.662/20 dhe 699/20 të datës 29.10.2020, si me larte.

Andaj, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE SH “DRINI COMPANY” SH.P.K. ankues i shpallur si tenderues i eliminuar nga AK-ja, se në dosje të tenderit dhe të njoftimit për kontratë për projektin e lartshënuar askund nuk është kërkuar DEKLARATË për specifikacione teknike. Nuk e di ku është thirrur AK dhe e ka kërkuar një gjë të tillë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE SH “DRINI COMPANY” SH.P.K, se AK në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar në piken 3 me

pretendim se: Tek specifikacioni teknik OE-së i mungojnë Deklaratat për specifikime teknike të detyrueshme të cilat duhet të ishin në dosje. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, respektivisht të dosjes së tenderit tek: Aneks 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme, thuhet: Referohuni në specifikimin teknik paramasa. Bazuar në këto AK-ja nuk ka kërkuar Deklaratë për specifikime teknike dhe ky pretendim i operatorit ekonomik është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues SH “DRINI COMPANY” SH.P.K. i shpallur si tenderues i eliminuar nga AK-ja, se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë pasi që nuk ka kontrata dhe referenca që e arrijnë vlerën e kërkuar për liderin 60%. Në dosje të tenderit është kërkuar:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 5.000.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues, duke u bazuar në listën e kontratave të dorëzuara sipas kërkesës në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, në të cilën shihet nga tabela nr.1 e dhënë më poshtë, se OE i shpallur fitues gjatë tri viteve të fundit (2016, 2017 dhe 2018-2019) ka realizuar kontrata të natyrës së ngjashme për punime në shumën prej 1.705.273,04 euro nga shumë e kërkuar, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme = $5.000.000,00 \times 60\% = 3.000.000,00$ euro të kërkuara për liderin e grupit. Prandaj, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE SH “DRINI COMPANY” SH.P.K. i shpallur si tenderues i eliminuar nga AK-ja, se grupi i OE Euroasphalt SH.P.K & Trasing Group SH.P.K. i shpallur fitues, në dosje të tenderit ka prezantuar një autorizim të kompanisë MGB për produktet SMARTI. Ndërsa, në ofertën e tij ka prezantuar katalog të prodhuesit LUG nga Polonia për të cilin nuk është i autorizuar. Edhe pse i ka prezantuar këto produkte përsëri OE nuk i plotëson kërkesat minimale të AK.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues, sqaron se anëtari i grupit Euroasphalt SH.P.K me dosjen e tenderit ka dorëzuar autorizimin nga “MBG” SH.P.K. për produktet SMART -“ TAB Systems Inc. është një zhvillues dhe prodhues i zgjidhjeve të përparuara teknologjike në fushën e sistemeve inteligjente të parkimit, zgjidhje automatike të automatizimit, zgjidhje inteligjente të ndriçimit LED nën emrin e markës smarti® “. Ndërsa në ofertën e tij, ka prezantuar katalog të prodhuesit LUG nga Polonia për të cilin nuk është i autorizuar. Si dhe katalogun smarti®, për të cilin është i autorizuar dhe është një zhvillues dhe prodhues i zgjidhjeve të përparuara teknologjike në fushën e sistemeve inteligjente të parkimit, zgjidhje automatike të automatizimit, zgjidhje inteligjente të ndriçimit LED nën emrin e markës smarti®, ku këto shkresa janë bashkangjitur në raportin e

ekspertit. Prandaj, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues SH “DRINI COMPANY” SH.P.K. i shpallur si tenderues i eliminuar nga AK-ja, se OE i shpallur fitues Euroasphalt SH.P.K & Trasing Group SH.P.K, për pikën e autorizimit për sinjalizim horizontal dhe vertikal ka prezantuar një autorizim për kompanisë ITK SH.P.K. nuk ka dëshmi se OE ITK SH.P.K. është distributor i autorizuar për Kosovë i kompanisë 3M, në dëshminë e sjellë thuhet se OE ITK SH.P.K është vetëm furnizuar me produkte të 3M, e jo ka drejtë të distribujë apo që është përfaqësues i autorizuar i 3M. Gjithashtu, nuk ka sjell asnjë dëshmi se kompania ITK SHPK, është distributor i autorizuar i kompanisë SËARCO AG. Nuk ka asnjë dëshmi.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues, duke u bazuar në autorizimet e dorëzuara nga OE i shpallur fitues Euroasphalt SH.P.K & Trasing Group SH.P.K, sqaron se OE Euroasphalt SH.P.K – Gjakovë ka dorëzuar autorizimin në mes të “International Traffic Kosova” I.T.K SH.P.K dhe “Euroasphalt SH.P.K”- Gjakovë, ndërsa nuk ka dorëzuar autorizimin në mes të “International Traffic Kosova” I.T.K SH.P.K dhe kompanisë SËARCO – Austri për sinjalizim horizontal, si dhe kompanisë Zvicerane 3M për sinjalizim vertikal. Paneli Shqyrtues sqaron se në raportin e ekspertit është bashkangjitur autorizimi i në mes të “Euroasphalt SH.P.K” dhe “International Traffic Kosova” I.T.K SH.P.K.

Prandaj, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues SH “DRINI COMPANY” SH.P.K. i shpallur si tenderues i eliminuar nga AK-ja, se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit pasi që ka sjellë katalog dhe certifikata EN që nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. OE ka dorëzuar katalog dhe certifikata të cilat nuk përkojnë me kërkesat e dosjes së tenderit edhe të cilat janë për kompani tjera që ky nuk është i autorizuar, siç është rasti me LUG, CEANSOL etj.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE, sqaron se duke u bazuar në katalogët dhe certifikatat EN të dorëzuara nga OE i shpallur fitues Euroasphalt SH.P.K & Trasing Group SH.P.K, sqaron se OE Euroasphalt SH.P.K –Gjakovë ka dorëzuar katalogë dhe certifikata të cilat janë për kompani tjera që as njeri nga anëtarët e grupit “Euroasphalt SH.P.K & Trasing Group SH.P.K” nuk janë të autorizuar, siç është rasti me LUG, CEANSOL. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në

procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka pasur parasysh kërkesat e dosjes së tenderit, duke mos vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet autoriteti kontraktues që me rastin e rivlerësimit të ofertave të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, si të bëjë vlerësimin e ofertave sipas kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerina DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Gjakovë";
- 1x1 OE "Pe-vla-ku" SH.P.K-Dega në Kosovë Prishtinë;
- 1x1 OE "Drini Company" SH.P.K-Prizren;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së